



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETTIT PUBLIK  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 20.02.2023

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim i leximit primar të mamografive” MK për 24 muaj**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
SHËRBIME TË NDRYSHME**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 5 100 000 (pesë milionë e njëqindmijë) lekë pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Instituti i Shëndetit Publik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas *Shtojcës 3*;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas *shtojcës 9*.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, nenit 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**2.1.1** Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme sipas deklaratave në Shtojcën 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

### **2.1.2 Licence e lëshuar nga QKB për kategorine II.6.A(4)**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 2 040 000 (dymilionë e dyzetmijë) lekë. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti OE duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të kërkuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$5\ 100\ 000 \times 40\% = 2\ 040\ 000$$

Përcaktimi i vlerës është kryer brenda kufirit të vlerës së përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues, nëpërmjet xhiros së realizuar në një nga tre vitet e kërkuara. AK ka parashikuar vlerën jo më pak se 40 % në mënyrë që të nxisë pjesëmarrjen e sa më shumë OE-ve të cilat kanë eksperiencën e nevojshme dhe stabilitetin e nevojshëm për të kryer me sukses kontratën në rastin e shpalljes fitues, i cili është në përputhje me natyrën, vlerën e objektit të kontratës.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.*

Vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2022 nuk konsiderohet sepse, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë afat deri më 31.03.2023.

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se **15 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 15 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenit 55 tw sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben autoritetit kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 15% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë për të provuar ekspseriencën , qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

*AK ka parashikuar vlerën jo më të vogël se 15 % në mënyrë që të nxisë pjesëmarrjen e sa më shumë OE-ve të cilat kanë eksperiencën e nevojshme dhe stabilitetin e nevojshëm për të kryer me sukses kontratën në rastin e shpalljes fitues, kërkesë kjo e cila është në përputhje me natyrën, vlerën e objektit të kontratës*

---

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Deklarate nga OE që disponon pajisjet dhe softet e nevojshme për të lexuar imazhet e mamografive të prodhuara nga njësia lëvizëse “Mamography Unit me X-Ray tube dhe Direct Conversion Amorphous Selenium detector 24x30 cm format me jo Isocentric (HELIANTHUS)”. OE ka te drejte te inspektoje paraprakisht llojin e pajisjeve qe kryejne ekzaminimet dhe prodhojne imazhet e mamografise, prane ambjenteve te ISHP-se.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 (b) dhe (ç) , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë aftësitë teknike nëpërmjet pasijeve dhe softetve e përshatshme për të garantuar AK për zbatimin e kontratës, me objekt leximin primar të imazheve të mamografisë.

2.3.3. OE duhet te kete te pakten nje punonjës i cili të jetë Mjek i diplomuar nga Fakulteti i Mjekësisë, gjithashtu i specializuar në specialitetin Diagnozë me Imazhe, dhe i licensuar nga Urdhëri i Mjekut të Shqipërisë për këtë specialitet( Diagnozë me Imazhe). Për këtë OE duhet të paraqesë diplomën e fakultetit të Mjekësisë, diplomën e specializimit dhe licensën nga e Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë, e cila duhet të jetë aktive për gjatë gjithë periudhës së kontratës. OE duhet te paraqese kontraten e punes midis OE dhe mjekut te licensuar .OE duhet te paraqese CV-te e mjeku/mjekeve të licensuar “Diagnozë me imazhe”ku të dëshmohet edhe përvoja e punës në lidhje me leximin e mamografive, shoqëruar me një referencë profesionale.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për stafin teknik është bërë në përputhje me specifikimet teknike dhe nevojës për kryerjen e shërbimit të leximit primar të mamografive, duke siguruar AK se OE zotëron burimet njerëzore teknike të nevojshme për të zbatuar kontratën, si dhe siguron cilësinë e stafit teknik nëpërmjet licencimit të tyre.

*(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/ certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).*

***Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.***

***Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.***

*(Kjo fjali është marrë identike si shfaqet edhe në modelet e “Dokumentet Standarde të Tenderit”, që gjenden në faqen e APP-së, për procedurat e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”)*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Specifikimet teknike të shërbimit objekt prokurimi janë përcaktuar nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor, si më poshtë vijon:*

*Ekzaminimet mamografike kryhen nga Njësitë lëvizëse të mamografive tip Helianthus të kompanisë prodhuese Metaltronica S.p.A. dhe kanë specifikimet e përgjithshme si më poshtë:*

*Mamography Unit me X-Ray tube dhe Direct Conversion Amorphous Selenium detector 24x30cm format me jo Isocentric (HELIANTHUS).*

*Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:*

- Modeli i kerkuar i pergjigjes nga ana e OE lidhur me leximin e imazheve duhet te paraqesi të informacionin si më poshtë:
  1. Emrin dhe mbiemrin e personit që ekzaminohet.
  2. Rrethi sipas kodit te vendosur ne Databasen e mamografise se levizshme.
  3. Moshë (data,muaji,viti)
  4. ID bazuar në kartën e identitetit të personit.
  5. Data e kryerjes se mamografise në terren.
  6. Data e leximit të mamografisë.
  7. Konkluzionet lidhur me gjetjet radiologjike.
  8. Kategorizimi sipas sistemit radiologjik BI-RADS dhe pershkrim per ndjekje te metejshme.
- Përgjigjet e leximit të mamografive duhet të jenë të nënshkruara nga mjeku që i ka lexuar dhe OE përkatës.
- Përgjigjet e leximit duhet të dorëzohen ne dy kopje edhe me CD prane AK, shoqeruar me listen analitike te emrave.

\* \* \*

Për sa më sipër, anëtarët e Njesisë së Prokurimit miratojnë nëpërmjet këtij procesverbali kriteret e mësipërme të kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë. Njësia e Prokurimit do t'i pasqyrojë ato në Dokumentet Standarde të Tenderit të kësaj procedure, dhe së bashku me DST, procesverbali do të ngarkohet në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Ngarkohet si personi i autorizuar për kryerjen e veprimeve në SPE Lindita Kokona e cila do të vijojë me dërgimin e dokumenteve të tenderit për publikim dhe hedhjen në sistem të dokumentacionit që kërkohet.

\* \* \*

Pasi lexohet, procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**